



WIZZ AIR MALTA LIMITED

**KUSHTET E PËRGJITHSHME TË TRANSPORTIT TË PASAGJERËVE DHE TË
BAGAZHEVE**

Në fuqi prej datës 1 prill 2023

Kushtet e përgjithshme të Transportit

1. Hyrje

- 1.1. Kur blini një biletë për të udhëtuar në një fluturim që ne e operojmë, ju lidhni një kontratë transporti me ne. Kontrata rregullohet nga (1) kushtet në biletën / itinerarin dhe faturën tuaj; (2) çdo tarifë që zbatohet; (3) kushtet e përgjithshme ligjore të transportit; dhe (4) çdo rregullore tjetër që mund të kemi herë pas here.
- 1.2. Këto janë kushtet e përgjithshme ligjore të transportit ("**Kushtet**" ose "**Kushtet e përgjithshme të transportit**") që zbatohen për rezervimin tuaj me Wizz Air Malta Limited, një kompani private me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Maltë me numrin e regjistrimit të kompanisë C 102218 dhe adresë të regjistruar në 171, Old Bakery Street, Valletta VLT 1455, Malta.

Këto Kushte përfshihen sikur të ishin përcaktuar plotësisht këtu dhe të cilat vetë zbatohen edhe për rezervimin tuaj:

- 1.2.1. Kushtet e përdorimit të Uebsajtit tonë, nëse përdorni Uebsajtin tonë ose Aplikacionin tonë; dhe
- 1.2.2. çdo Konfirmim rezervimi dhe çdo kusht specifik të përcaktuar në të.

Ju lutemi, lexoni me kujdes këto Kushte dhe sigurohuni që t'i kuptoni ato përpara se të rezervoni ndonjë fluturim të Wizz Air. Ne i përditësojmë Kushtet tona herë pas here dhe si të tilla, ato duhet të lexohen dhe kuptohen përpara çdo rezervimi të fluturimeve, pasi Kontrata e Transportit lidhet me pagesën e Tarifës Totale dhe lëshimin e Itinerarit nga Ne.

- 1.3. Shprehje dhe fjalë të veçanta në këtë dokument kanë kuptime specifike që mund të jenë unike për këtë dokument dhe mund të ndryshojnë nga linjat e tjera ajrore. Kur fjalë dhe fraza të caktuara shkruhen me shkronjë të madhe në këto Kushte, ato janë terma të përcaktuar me kuptimin e dhënë në Paragrafin 2 më poshtë.
- 1.4. Në këto Kushte, kur i referohemi "**Wizz Air**" ose "**ne**", "**Ne**", "**neve**", "**Neve**", "**tona**" ose "**Tona**", nënkuptojmë Wizz Air Malta Limited dhe kur i referohemi "**ju**", "**Ju**", "**Juaj**" ose "**juaj**", ne ju nënkuptojmë juve si Pasagjer ose Rezervues në një Rezervim.

2. **Kuptimi i fjalëve dhe shprehjeve të caktuara në këto Kushte/Përkufizime**

I RRITUR SHOQËRUES: pasagjer i rritur që ka të paktën gjashtëmbëdhjetë vjeç, i cili është në të njëjtin Rezervim si një Foshnjë ose Fëmijë dhe i shoqëron ata në një fluturim.

SHËRBIMET SHITESË: nënkupton çdo produkt dhe/ose shërbim të blerë prej Jush në lidhje me transportin ajror dhe që sigurohet, ofrohet ose shitet nga Ne ose ofruet palë të treta, për shembull, por pa u kufizuar me, makinë me qira ose akomodim në hotel. Në raste të caktuara Shërbimet shtesë mund të përbëjnë ligjërisht një Paketë.

TARIFA ADMINISTRATIVE E CAKTIMIT: tarifa e pagueshme për pasagjer për fluturim nëse ju caktoni kërkesën tuaj, siç parashikohet në Paragrafin 18.4.2, në shumën e specifikuar në Uebsajt në kohën e lidhjes së Kontratës.

APLIKACIONI: Aplikacioni celular Wizz Air i lidhur me Uebsajtin dhe i operuar nga ose për Wizz Air ku mund të bëhen rezervimet.

LIGJI I ZBATUESHËM: të gjitha ligjet, statutet, rregulloret, aktet nënligjore, kodet e detyrueshme të sjelljes dhe udhëzimet e detyrueshme, duke përfshirë Konventën, Rregulloren 2027/97 dhe Dekretin e Qeverisë S.L. 499.24, të zbatueshme për Rezervimin, udhëtimin tuaj me ne dhe çdo shërbim tjetër që ju ofrojmë sipas këtyre Kushteve.

BAGAZH: nënkupton pronën tuaj që ju shoqëron në udhëtimin tuaj si Bagazh i regjistruar, Bagazh i paregjistruar, Bagazh ekstra në bord ose Pronë personale (por duke përjashtuar çdo artikull të ndaluar nga transporti sipas këtyre Kushteve).

ETIKETA IDENTIFIKUESE E BAGAZHIT: një dokument që lëshohet vetëm për identifikimin e Bagazhit tuaj të regjistruar dhe që vendoset në Bagazhin tuaj të regjistruar.

ETIKETA KËRKUESE E BAGAZHIT: një dokument që lëshohet vetëm për identifikimin e Bagazhit tuaj të regjistruar, që i ngjitet Kartës suaj të imbarkimit.

REZERVUES: nënkupton individin në moshë madhore dhe që ka zotësi të plotë juridike ose një person juridik që vepron si ndërmjetës për Pasagjerin dhe që

kryen rezervimin në emrin e tij/saj dhe për llogari të tij/saj dhe/ose në emrat e Pasagjerëve të tjerë dhe për llogari të tyre. Rezervuesi përfshin gjithashtu një individ ose shoqëri që na paguan neve Tarifën e plotë të fluturimit siç tregohet në Itinerarin e një Pasagjeri dhe agjencive të udhëtimit.

REZERVIM: një rezervim për një ose më shumë fluturime të Wizz Air (me çdo Shërbim shtesë nëse ka) i cili konfirmohet si i pranuar nga Ne.

KARTA E IMBARKIMIT: një dokument (i) i lëshuar në sportelin e checkin-it kundrejt kodit tuaj të rezervimit ose itinerarit tuaj dhe Dokumenteve të vlefshme të udhëtimit; ose (ii) i printuar ose i shkarkuar prej jush ose i afishuar në pajisjen tuaj celulare nëse përdorni Aplikacionin (Passbook ose aplikacion tjetër me funksion të ngjashëm) pas plotësimit të procedurës së checkin-it në internet ose në celular, që ju lejon të hipni në bordin e avionit.

BAGAZHI I KABINËS: Bagazhi juaj përveç bagazheve të regjistruara në përputhje me këto kushte të përgjithshme të transportit, të përfshira në tarifë, që mbetet në kujdesin tuaj për të gjithë kohëzgjatjen e udhëtimit.

CALL CENTER: shërbimi për klientët që jepet përmes telefonit, numrat aktualë të telefonit të cilët mund të gjenden në Uebsajt.

TARIFA E ANULIMIT: tarifa e pagueshme prej jush nëse anuloni një rezervim, siç përcaktohet në Paragrafin 6.4.1 dhe në shumën e përcaktuar në Uebsajt në momentin e lidhjes së kontratës.

MARRËVESHJE CHARTER: një kontratë për transport Charter e lidhur në përputhje me këto Kushte të përgjithshme transporti.

BAGAZHET E REGJISTRUARA: Bagazhet tuaja që ne i marrim në dorëzim për qëllim transportimi, dhe për të cilat kemi lëshuar një Etiketë identifikimi Bagazhi dhe një Etiketë kërkuese Bagazhi në momentin e marrjes në dorëzim.

AFATI PËRFUNDIMTAR I CHECKIN-it:: kufiri kohor deri në të cilin duhet të keni përfunduar formalitetet e checkin-it dhe të keni marrë Kartën e imbarkimit.

KODI CIVIL: Kodi Civil Maltez, Kapitulli 16 i ligjeve të Maltës.

KODI I PROCEDURËS CIVILEC: Kodi Maltez i Organizimit dhe Procedurës Civile, Kapitulli 12 i ligjeve të Maltës.

KUSHTET E KONTRATËS: kushtet e përfshira në Itinerarin tuaj dhe këto Kushte të përgjithshme të transportit.

KONTRATA (PËR TRANSPORTIN AJROR): kontrata për transportin ajror të Pasagjerëve dhe të Bagazheve, e lidhur mes jush dhe Wizz Air në përputhje me Kushtet e kontratës, në bazë të së cilës ne ju transportojmë juve dhe Bagazhin tuaj nga Vendi i nisjes në Vending e destinacionit. Kontrata përbëhet nga Itinerari dhe Etiketa identifikuese e Bagazhit (nëse lëshohet).

KONVENTA: “Konventa e Montrealit për unifikimin e rregullave të caktuara në lidhje me transportin ajror”, e nënshkruar në Montreal më 28 maj 1999, me ndryshimet dhe shtesat përkatëse.

VENDET E PREKURA NGA TRANSPORTI: ato vende në të cilat ndodhen Vendi i Nisjes dhe Vendi i Destinacionit.

EKUIPAZHI: personeli i autorizuar që kryen detyrat në bordin e avionit, të tillë si pilotët, stjuardesat, personeli teknik dhe i sigurisë.

DITË: ditët kalendarike, duke përfshirë të shtatë ditët e javës, me kusht që për qëllime njoftimi, dita në të cilën jepet njoftimi nuk do të numërohet në afatin përfundimtar.

BE: Bashkimi Evropian, duke përfshirë shtetet e veta anëtare.

BAGAZH EKSTRA NË BORD: Bagazhi juaj veç Bagazheve të regjistruara dhe të Kabinës në përputhje me këto Kushte të përgjithshme të transportit, me Tarifatat përkatëse të shërbimit, që merret në bord për të gjithë kohëzgjatjen e udhëtimit.

TARIFA E FLUTURIMIT: çmimi i transportit ajror nga Vendi i nisjes deri në Vending e destinacionit. Tarifa e fluturimit përfshin taksat dhe tarifatat (duke përfshirë taksat aeroportuale dhe taksat qeveritare të parashikuara), një Bagazh kabine dhe shumën më të ulët të disponueshme të Tarifave për Shërbimet e tjera të pashmangshme për qëllimin e rezervimit.

TARIFAT PËR SHËRBIMET E TJERA/TARIFAT E SHËRBIMEVE: tarifatat e pagueshme për shërbime të ndryshme në lidhje me transportin ajror, të përcaktuara në Uebfaqen, përveç Tarifës për ruajtjen e ndenjësës, Tarifës së anulimit, Tarifës së Wizz Discount Club dhe tarifës së pagueshme për Shërbimet shtesë.

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË TRANSPORTIT: dispozitat e aplikueshme për transportin ajror të Pasagjerëve dhe Bagazheve të kryer nga Wizz Air, të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme të transportit, si edhe ato të referuara si **KUSHTE**.

ITINERARI: (i) dokumenti që përmban informacione kyçe të lëshuara për Pasagjerët pas pagesës së plotë të Tarifës totale të fluturimit të Wizz Air ose (ii) në rast ndryshimesh në rezervim nga Pasagjeri, dokumenti i lëshuar për Pasagjerin si pranim i këtyre ndryshimeve nga Wizz Air.

ETIKETA E LËSHIMIT TË KUFIZUAR: dokumenti që deklaron përgjegjësinë tonë të kufizuar për Bagazhin e regjistruar që në ndonjë mënyrë është dëmtuar ose nuk është në madhësinë apo kushtet e duhura, ose që përmban artikuj të brishtë të pranuar prej nesh për transport dhe që është lëshuar në kohën e marrjes në dorëzim të këtij Bagazhi.

I MITUR: Pasagjer i cili është nën 14 vjeç në momentin e udhëtimit dhe ku **FOSHNJË** është një fëmijë mosha e të cilit është nën dy vjeç, por jo më pak se dy javë dhe një **FËMIJË** është mbi moshën dy vjeç dhe nën moshën 14 vjeç, më shumë se një fëmijë janë **FËMIJËT**.

TARIFA PËR HUMBJEN E FLUTURIMIT: nënkupton tarifën e pagueshme në raste të caktuara ku ju humbni fluturimin tuaj dhe dëshironi të transferoheni në një fluturim tjetër të operuar prej nesh. Shuma e tarifës përcaktohet në Uebsajt.

SHËRBIME TË TJERA: nënkupton çdo produkt dhe/ose shërbim të blerë nga Ju, të cilat sigurohen, ofrohen ose shiten me pakicë nga Ne ose nga një ofrues palë e tretë, përveç atyre në lidhje me Kontratën për Transportin Ajror ose Shërbimet shtesë.

UDHËTIMI ME PAKETË nënkupton paketën sipas nenit 2 **UDHËTIMI ME PAKETË DHE ORGANIZIMET E LIDHURA PËR UDHËTIM**, Legjislacioni Suplementar 409.19,, raste në të cilat Wizz Air konsiderohet si organizator ose shitës i paketës. Në rast se kombinimi i Shërbimit shtesë të zgjedhur, përbën Paketë, Wizz Air ju njofton gjatë rezervimit.

UDHËTIMI ME PAKETË DHE ORGANIZIMET E LIDHURA PËR UDHËTIM: Legjislacioni Suplementar Maltez 409.19 i Ligjeve të Maltës mbi rregullat e kontratave për shërbime udhëtimi dhe në veçanti kontratat për paketa udhëtimi dhe organizimet e lidhura për udhëtim.

PASAGJER: do të thotë çdo person ose persona në një rezervim të kryer ose që do të transportohet në një fluturim të Wizz Air (përveç anëtarëve të Ekuipazhit).

PASAGJER ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË LËVIZJE OSE QË KËRKON ASISTENCË TË VEÇANTË (“PRM”): nënkupton çdo pasagjer me aftësi të kufizuara në lëvizje për shkak të paaftësisë fizike (ndijore ose lokomotore), dëmtimit intelektual, moshës, sëmundjes ose çdo shkakut tjetër aftësie të kufizuar kur përdor transportin ose situata e të cilit ka nevojë për vëmendje të veçantë.

PRONA (PRONAT) PERSONALE: nënkupton artikujt e listuar në Paragrafin 15.3.5 të këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit që Ju mund të merrni në bord, përveç bagazheve të regjistruara, pa pagesë.

VENDI I NISJES: aeroporti i treguar në itinerar dhe në databazën Tonë si pika e nisjes së transportit ajror.

VENDI I DESTINACIONIT: aeroporti i destinacionit i transportit ajror i treguar si i tillë në itinerar dhe në databazën tonë.

POLITIKA E PRIVATËSISË: politika në Uebsajtin tonë që rregullon trajtimin e të dhënave personale që jepen prej jush ose Rezervuesit të Wizz Air.

QEN NDIHMËS I PRANUAR nënkupton siç specifikohet në përputhje me Rregulloren 1107/2006/EC.

Qentë ndihmës të pranuar:

Qen ndihmës për personat e verbër dhe me shikim të kufizuar

Qen ndihmës ndihmës për personat me lëvizshmëri të reduktuar

Qen ndihmës për personat me humbje dëgjimi

Qen sinjalizues për kriza epileptike

Qen shërbimi që ndihmon personat me aftësi të kufizuara

RREGULLORJA 261: “Rregullorja (KE) Nr. 261/2004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit”, me ndryshimet ose shtesat përkatëse.

RREGULLORJA 2027/97: Rregullorja (EC) Nr. 2027/97 e Këshillit e datës 9 tetor 1997 mbi përgjegjësinë e operatorit ajror në lidhje me transportin ajror të pasagjerëve dhe bagazheve të tyre (ndryshuar nga Rregullorja (EC) Nr. 889/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 13 majit 2002).

ORARI: orari i mbërritjes dhe i nisjes i fluturimeve individuale të përcaktuara nga Wizz Air dhe të publikuara në Uebsajt.

SDR: E drejta speciale për tërheqje, sipas përkufizimit nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. (Vlera aktuale e kësaj monedhe mund të gjendet në Uebfaqin e FMN-së – www.imf.org – dhe në faqet financiare të gazetave të mëdha.)

TARIFA PËR RUAJTJEN E NDEJËSES: tarifa e pagueshme prej jush në shumën e përcaktuar në Uebfaqin në momentin e lidhjes së Kontratës nëse Wizz Air ushtron të drejtën e vet të anulohet rezervimin tuaj në përputhje me këto Kushte të përgjithshme transporti, ose ju anuloni rezervimin siç përcaktohet në klauzolën 6.4.2.

OFRUESI I SHËRBIMIT: nënkupton ofruesin palë të tretë që ofron, siguron, zhvillon ose shet Shërbimet shtesë, duke përfshirë edhe nëse ofrohen të bashkëpunim ose në emër të një pale tjetër të tretë.

S.L. 499.24: Legjislacioni Suplementar 499.24, Urdhri i Transportit Ajror (Transporti Ndërkombëtar dhe Jo-ndërkombëtar).

TARIFAT: tarifat e publikuara, tarifat dhe Kushtet përkatëse që janë paraqitur, aty ku kërkohet, pranë autoriteteve përkatëse, ku detajet e tyre janë të disponueshme në Uebfaqin, si në lidhje me tarifën totale ashtu edhe me kushtet dhe tarifat përkatëse për shërbime të ndryshme të ofruara nga Ne; dhe rregullore të tjera të Wizz Air. Informacione të mëtejshme rreth Tarifave tona mund të gjenden në Uebfaqin tonë në lidhjen: [https://wizzair.com/en-gb/information-and-services/prices-discounts/all-services-fees#/.](https://wizzair.com/en-gb/information-and-services/prices-discounts/all-services-fees#/)

TARIFA TOTALE E FLUTURIMIT: çmimi i pagueshëm për të gjitha shërbimet e ofruara për Ju nga Wizz Air, i cili përfshin Tarifën e fluturimit për transportin ajror dhe Tarifat për Shërbimet e tjera ose tarifat për çdo shërbim tjetër që ju blini në Uebfaqin.

DOKUMENTET E UDHËTIMIT: dokumentet e kërkuara nga Vendet e prekura nga Transporti për kalimin e kufirit, kalimin tranzit dhe/ose qëndrimin në shtetin e caktuar.

BAGAZHET E PAREGJISTRUARA: Bagazhet tuaja përveç Bagazheve të regjistruara në përputhje me këto Kushte të përgjithshme të transportit, që merren në bord gjatë gjithë kohëzgjatjes së udhëtimit.

UEBSAJTI: www.wizzair.com

3. Zbatueshmëria, Zgjedhja e Ligjit dhe Juridiksioni

3.1. Dispozitat e përgjithshme

- 3.1.1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga Konventa ose Ligji i zbatueshëm, kontrata juaj e transportit me Ne dhe këto Kushte të përgjithshme të Transportit do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me ligjet e Maltës.
- 3.1.2. Këto Kushte do të zbatohen për çdo fluturim të deklaruar në Itinerar siç operohet nga Wizz Air si operator (pavarësisht se kush është operatori i transportit ajror) dhe për çdo fluturim të kryer ndryshe nga Wizz Air.
- 3.1.3. Përveç këtyre Kushteve, nëse blini Shërbime Shtesë të ofruara nga ose nëpërmjet nesh nëpërmjet një ofruesi tjetër shërbimi, Kushte të tjera të përgjithshme specifike mund të zbatohen për ato shërbime, ku duhet të siguroheni që i keni lexuar të dyja këto Kushte, të gjitha informacionet dhe njoftimet përkatëse dhe kushtet e përgjithshme për çdo Shërbim shtesë të ofruar nga Ofruesi përkatës i Shërbimit, përpara se të përfundoni transaksionin tuaj me Ne ose me Ofruesin e Shërbimit (përkatësisht). Kushtet tregohen në momentin e rezervimit dhe në konfirmimin(et) e rezervimit për ato shërbime dhe në disa raste, në Uebsajtin tonë. Për të mësuar më shumë, ju lutemi vizitoni Uebsajtin tonë.
- 3.1.4. Në raste të caktuara, shërbimet shtesë të blera mund ta ta bëjnë Rezervimin tuaj një Udhëtim me paketë. Në një rast të tillë, mund të zbatohen gjithashtu përveç dispozitave të këtyre Kushteve, rregullat e aplikueshme për udhëtimet me paketë dhe organizimet e lidhur të udhëtimit (si dhe kushte të tjera specifike siç përshkruhen në Paragrafin 23).
- 3.1.5. Nëse blini Shërbime shtesë pas kryerjes së Rezervimit tuaj që nuk përbëjnë Udhëtim me paketë, atëherë kontrata për çdo Shërbim shtesë lidhet mes jush dhe Ofruesit përkatës të shërbimit dhe ne nuk do të kemi asnjë detyrim ndaj jush në lidhje me ofrimin ose përmbushjen e këtyre Shërbimeve shtesë. Çmimi për çdo Shërbim shtesë ofrohet vetëm nga Ofruesi përkatës i shërbimit. Duke pranuar çdo ofertë dhe duke kryer pagesën përmes Uebsajtit, ju gjithashtu autorizoni WizzAir të marrë pagesën tuaj dhe t'ia dërgojë atë në emrin tuaj Ofruesit përkatës të Shërbimit. Në disa raste, tarifa për Shërbimet shtesë është e pagueshme direkt nga ju tek Ofruesi i shërbimit.

3.2. Transporti Charter

Nëse transporti kryhet në përputhje me një Marrëveshje Charter, këto Kushte zbatohen vetëm në masën që ato janë të përfshira, me referencë ose ndryshe, në Marrëveshjen Charter ose Rezervimin (së bashku me ndryshimet që mund të përcaktohen në biletën Charter ose rregulloren Charter në Paragrafin 23).

3.3. Zgjedhja e ligjit dhe juridiksioni

- 3.3.1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga Konventa ose Ligji i zbatueshëm, kontrata juaj e transportit me Ne dhe këto Kushte të përgjithshme të Transportit do të rregullohen dhe interpretohen në përputhje me ligjet e Maltës.
- 3.3.2. Gjykatat malteze do të kenë juridiksion joekskluzive në çdo mosmarrëveshje kontraktuale ose jokontraktuale që lind nga ose në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë, pa kufizim, formimin, vlefshmërinë dhe zgjidhjen e saj.

Me kusht që:

- (i) Nëse jeni konsumator rezident në një Shtet Anëtar të BE-së, mund të jeni gjithashtu në gjendje të sillni procedime në gjykatat e atij Shteti Anëtar; dhe
- (ii) Për pretendimet e bëra sipas Konventës dhe Rregullores 2027/97, ju gjithashtu mund të jeni në gjendje të sillni procedime para gjykatave të vendit të destinacionit të fluturimit. Nëse kërkesa ka të bëjë me vdekje ose lëndim, atëherë një opsjon tjetër do të përfshinte gjykatat e vendbanimit të pasagjerit.

4. Rezervimi

4.1. Kryerja e një rezervimi

- 4.1.1. Fluturimet mund të rezervohen direkt me ne përmes Uebsajtit, Aplikacionit tonë ose Call Center-it tonë ose në Sportelin tonë të biletave në aeroport (nëse disponohet).
- 4.1.2. Rezervimi nuk do të jetë përfundimtar pa pagesën e Tarifës totale të fluturimit në momentin e rezervimit, përveçse kur përcaktohet këtu ndryshe. Ne rezervojmë të drejtën të anulojmë Rezervimin tuaj nëse Tarifa totale e fluturimit nuk është paguar plotësisht.

- 4.1.3. Nëse nuk keni zgjedhur të përdorni shërbimin tonë fleksibël të partnerit të udhëtimit, ju duhet të na jepni emrin tuaj të plotë siç përfshihet në Dokumentin tuaj të Udhëtimit. Nëse nuk e bëni këtë gjatë rezervimit ose brenda 2 orëve nga rezervimi përmes Call Center-it tonë, do të paguhet një tarifë administrative për ndryshimin e emrit për korrigjimin e emrit të Pasagjerit, shuma e të cilës jepet në Uebsajtin, Aplikacionin dhe në Call Center-in tonë. Ju lutemi shikoni Uebsajtin tonë për detaje të mëtejshme mbi shërbimin tonë fleksibël të partnerit të udhëtimit.
- 4.1.4. Juve ju kërkohet të na jepni informacionin e kontaktit, (numrat e telefonit dhe adresat e emailit), në të cilat mund të kontaktohen në çdo kohë. Është përgjegjësia juaj të siguroheni që informacioni i dhënë i kontaktit është dhe mbetet i saktë dhe që ju të kontrolloni rregullisht adresën tuaj të emailit (kutinë hyrëse dhe postën e padëshiruar). Ne nuk do të jemi përgjegjës për asnjë dëmtim që lind nga moszbatimi nga ana juaj i kërkesave të mësipërme.
- 4.1.5. Nëse Rezervuesi nuk është një Pasagjer ose Rezervuesi po bën një rezervim për Pasagjerë të tjerë, Rezervuesi do të konsiderohet se, duke vepruar si agjent, i pranon këto Kushte për llogari dhe në emër të Pasagjerëve të përmendur në rezervim dhe, duke bërë atë rezervim, na siguron dhe na garanton se ka autorizim të plotë dhe të vlefshëm nga Pasagjeri për ta bërë këtë. Të gjitha rezervimet (së bashku me itineraret e tyre) do t'u nënshtrohen këtyre Kushteve dhe do të jenë të detyrueshme si për Rezervuesin ashtu edhe për Pasagjerin e përmendur në Rezervim.
- 4.1.6. Gjithashtu, nëse Rezervuesi nuk është Pasagjer dhe jepen në Rezervimin tuaj të dhënat e të kontaktit të Rezervuesit, ju pranoni se Rezervuesi:
- (i) do të jetë përgjegjës për pranimin dhe transmetimin e çdo komunikimi nga Ne ose Ofruesit tanë të shërbimit në lidhje me rezervimin të të gjithë Pasagjerët; dhe
 - (ii) PËRVEÇSE NUK UDHËZOHET NDRYSHE ME SHKRIM NGA REZERVUESI APO PASAGJERI, NE DO TË SUPOZJMË SE REZERVUESI KA AUTORIZIM TË VLEFSHËM NGA AI PASAGJER PËR TË MARRË ÇDO KUFIZIM DHE, ATY KU ËSHTË E ZBATUESHME SHPENZIMET RASTËSORE OSE KOMPENSIMIN PËRKATËS DHE TË PAGUESHËM SIPAS REZERVIMIT. NE NUK DO TË KEMI ASNJË PËRGJEGJËSI PËR TË GARANTUAR QË KËTO SHUMA DËRGOHEN APO TRANSFEROHEN NDRYSHE NGA REZERVUESI TË PASAGJERIT.

- 4.1.7. Nëse jeni një PRM dhe/ose kërkonit asistencë të veçantë (duke përfshirë, por pa u kufizuar me transportimin e një qeni ndihmës të pranuar), juve ju kërkohet të na njoftoni rreth aftësisë suaj të kufizuar fizike ose në lëvizje dhe llojin e mjetit ndihmës për lëvizje apo ndihmave të tjera që dëshironi të transportoni ose që keni nevojë, ose çdo ndryshim në to, 48 orë përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit tuaj qoftë duke telefonuar Call Center-in tonë në numrat e dedikuar ose duke përdorur adresën e dedikuar të emailit. Për numrin e telefonit dhe adresën e emailit, ju lutemi vizitoni Uebsajtin.
- 4.1.8. Nëse dëshironi të transportoni Bagazhe speciale ose artikuj me transport të kushtëzuar, Ju duhet të telefononi dhe informoni Call Center-in tonë përkatësisht (shikoni Paragrafin 15.5). Për më shumë informacion, vizitoni Uebsajtin tonë.

4.2. Kryerja e një Rezervimi përmes Agjentëve

- 4.2.1. Rezervimi nga Agjenti do të bëhet nëpërmjet llogarisë së agjencisë WIZZ ose nëpërmjet Call Center-it.
- 4.2.2. Në rastin e Agjencive të kontraktuara, rezervimi do të bëhet siç specifikohet në kontratën e lidhur ndërmjet Agjencisë së kontraktuar dhe Wizz Air.
- 4.2.3. Agjenti ose Agjencia do të japin (1) (dhe kur ka ndryshime të mëvonshme, do të përditësojnë) detajet e tyre të kontaktit (përfshirë adresën e emailit, adresën postare dhe numrin e telefonit) për Agjencinë; dhe (2) numrin e telefonit të drejtpërdrejtë të Pasagjerit në Rezervimin e bërë nga Agjencia përmes llogarisë së agjencisë WIZZ.
- 4.2.4. Të gjithë Agjentët dhe Agjencitë do të respektojnë kushtet e përgjithshme të përshkruara në këto Kushte të përgjithshme të Transportit dhe ato të përcaktuara në Kushtet e përgjithshme të llogarisë së agjencisë WIZZ, si dhe të sigurojnë që Ju gjithashtu të jeni në dijeni të Kushteve përpara konfirmimit të Rezervimit. Duke kryer një Rezervim, Agjenti ose, sipas rastit, Agjencia na siguron dhe na garanton se ka informuar dhe i ka dhënë Pasagjerit një kopje të këtyre Kushteve dhe se ka autorizim të plotë dhe të vlefshëm nga Pasagjeri për të pranuar këto Kushte për llogari dhe në emër të pasagjerit dhe për ta lidhur Pasagjerin me ato kushte.

4.3. Rezervimi për një grup

- 4.3.1. Ju mund të bëni një Rezervim standard për deri në 11 Pasagjerë në Uebsajtin tonë. Për rezervime të më shumë se 11 Pasagjerëve, Ju duhet të na kontaktoni përmes

një formulari të veçantë, detaje të mëtejshme të të cilit mund të gjenden në Uebsajtin tonë.

- 4.3.2. Nëse dy ose më shumë anëtarë të grupit janë PRM dhe/ose kërkojnë asistencë të veçantë (duke përfshirë, por pa u kufizuar me transportimin e një qeni asistues të pranuar), juve ju kërkohet të na njoftoni rreth aftësisë suaj të kufizuar fizike ose në lëvizje dhe llojin e mjetit ndihmës për lëvizje apo ndihmave të tjera që dëshironi të transportoni ose që keni nevojë, ose çdo ndryshim në to, 48 orë përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit tuaj qoftë duke telefonuar Call Center-in tonë në numrat e dedikuar ose duke përdorur adresën e dedikuar të emailit. Për numrin e telefonit dhe adresën e emailit, ju lutemi vizitoni Uebsajtin.

4.4. Konfirmimi i Rezervimit

- 4.4.1. Pas pagesës së Tarifës totale të fluturimit, ne do të konfirmojmë Rezervimin tuaj dhe do të lëshojmë Itinerarin.
- 4.4.2. Itinerari (në rastin e transportit të Bagazhit, Etiketa identifikuese e Bagazhit) certifikon lidhjen e Kontratës për transportin ajror mes jush dhe nesh dhe nuk do të lëshohet biletë e veçantë.
- 4.4.3. Ne do t'u sigurojmë transportin personave (d.m.th., pasagjerëve) të përmendur në Itinerar dhe mund t'ju kërkohet të paraqisni identifikimin e duhur.
- 4.4.4. Çdo ndryshim i rënë dakord për Rezervimin tuaj do të përfshihet në një Itinerar të ri. Në rast të tillë, itinerari i sapolëshuar do të certifikojë Kontratën e transportit që prej lëshimit të tij.
- 4.4.5. Ju mund të kërkoni zëvendësim (ridërgim) të Itinerarit tuaj ose të kodit tuaj të rezervimit duke telefonuar Call Center-in tonë. Ne mund t'ju ngarkojmë një tarifë administrimi për këtë shërbim.
- 4.4.6. Nëse mendoni se keni kryer një Rezervim, por nuk keni marrë konfirmimin e Itinerarit dhe Rezervimit, ju lutemi kontaktoni me Call Center-in tonë.

5. Tarifat dhe pagesa

5.1. Tarifat tona të fluturimit

Tarifat e fluturimit janë vetëm për fluturimet tuaja specifike. Tarifat tona të fluturimit mbulojnë vetëm transportin tuaj ajror nga aeroporti në aeroport dhe

nuk përfshijnë transportin tokësor ose ndonjë shtesë tjetër, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe.

5.2. Tarifa totale e fluturimit

Shuma e Tarifës së fluturimit dhe Tarifa totale e fluturimit llogariten në përputhje me shumat në fuqi në kohën e Rezervimit në lidhje me transportin e caktuar siç tregohet në Uebfaqe ose Aplikacion. Tarifa e fluturimit dhe Tarifa totale e fluturimit (duke përfshirë, por pa u kufizuar me, Tarifat) nuk do të ndikohen nga ndryshimi i këtyre shumave midis datës së Rezervimit dhe datës së fillimit të udhëtimit (përveçse kur ndryshoni Rezervimin tuaj dhe siç përcaktohet në Paragrafin 4.4.4).

5.3. Taksat dhe Tarifat

- 5.3.1. Përveç nëse jepet shprehimisht ndryshe, Ne paguajmë të gjitha taksat dhe tarifat në lidhje me Rezervimin tuaj, të cilat shkaktohen deri në momentin e konfirmimit të Rezervimit tuaj, pra lëshimit të Itinerarit. Të gjitha këto taksa dhe tarifa janë të pakthyeshme.
- 5.3.2. Çmimet tona nuk përfshijnë asnjë tarifë dhe tarifë tjetër të palëve të treta për kostot që ne kemi për të ofruar shërbimet tona (të tilla si tarifat e aeroportit dhe të sigurisë, tarifat e mirëmbajtjes etj.). Shpenzimet për këto shërbime i përballojmë ne.
- 5.3.3. Taksat, tarifat dhe pagesat e vendosura për udhëtimet ajrore ndryshojnë vazhdimisht dhe mund të vendosen pas datës së lëshimit të Itinerarit (d.m.th. pas konfirmimit të Rezervimit tuaj). Duke pranuar këto Kushte të Përgjithshme të Transportit, ju pranoni se do të paguani çdo taksë, pagesë ose tarifë (duke përfshirë Tarifat për shërbime shtesë dhe çdo Shërbim tjetër) që lidhet me Rezervimin tuaj, të vendosura nga qeveritë, autoritetet e tjera ose nga operatorët e aeroportit ndërmjet datës së lëshimit të Itinerarit (d.m.th. pas konfirmimit të Rezervimit) dhe të udhëtimit tuaj, me efekt prapaveprues, sipas rastit. Nëse nuk i paguani këto shuma ne kemi të drejtën të refuzojmë transportin tuaj në përputhje me Paragrafin 13. Në rast se Tarifa totale e fluturimit rritet në mënyrë të konsiderueshme si rezultat i një shume të re ose të rritur të taksave, pagesave ose tarifave të vendosura nga qeveritë, autoritetet e tjera ose operatorët e aeroporteve, ju keni të drejtën të anuloni rezervimin tuaj dhe të merrni rimbursim të Tarifës totale të fluturimit.

5.3.4. TVSH-ja nuk ngarkohet për tarifën e fluturimit ose tarifën në lidhje me fluturimet ndërkombëtare. Për fluturimet e brendshme ne e paguajmë të gjithë TVSH-në në lidhje me Rezervimin tuaj, prandaj nuk mbledhim ndonjë pagesë specifike nga Ju për këtë arsye.

5.4. Tarifat

5.4.1. Tarifat tona janë të disponueshme në Uebfaqin tonë. Ne ruajmë të drejtën e ndryshimeve të Tarifave tona. Me kërkesën tuaj juve do t'ju jepet informacion rreth Tarifave tona në Call Center-in tonë.

5.4.2. Punonjësit, punëtorët e shërbimit dhe agjentët tanë janë të detyruar të pajtohen me Tarifat tona.

5.4.3. NËSE BËNI REZERVIM DHE/OSE BLINI NJË PREJ SHËRBIMEVE SHITESË OSE SHËRBIMEVE TË TJERA:

(i) TE AGJENTI YNË I PËRPUNIMIT TË BILETAVE NË AEROPORT, MUND T'JU KËRKOHEM T'I PAGUANI NJË TARIFË SHITESË AGJENTIT TONË PËRVEÇ TAKSËS SË SHËRBIMIT PËRKATËS TË CAKTUAR NË UEBSAJT OSE APLIKACION. INFORMACIONI RRETH TARIFAVE SHITESË QË MBAHEN NGA AGJENTI YNË DISPONOHET NGA AGJENTI NË AEROPORT;

(ii) PËRMES CALL CALL CENTER-IT, JU DUHET TË PAGUANI NJË TARIFË SHITESË PËRVEÇ TAKSËS PËRKATËSE TË SHËRBIMIT TË PARAQITUR NË UEBSAJTIN TONË OSE DUKE TELEFONUAR CALL CENTER-IN TONË.

5.5. Tarifat për Shërbime shtesë dhe Shërbime të tjera

5.5.1. Disa Shërbime shtesë dhe Shërbime të tjera mund të blihen nga Ju pasi të keni bërë Rezervimin tuaj.

5.5.2. Blerja mund të bëhet përmes Uebfaqit, Aplikacionit dhe – në varësi të Paragrafit 5.4.3 (i) dhe 5.4.3 (ii) – në aeroport ose përmes Call Center-it, në varësi të llojit të shërbimit.

5.5.3. Tarifat për Shërbime shtesë dhe/ose Shërbime të tjera mund të ndryshojnë pas datës së Rezervimit. Tarifat për Shërbime shtesë dhe/ose Shërbime të tjera do të jenë Tarifa e aplikueshme në datën e blerjes, detajet e së cilës janë të disponueshme në Uebfaqin tonë, Aplikacionin tonë ose nga Call Center-i ynë.

5.6. Monedha

- 5.6.1. Tarifa e fluturimit, Tarifat për Shërbimet shtesë dhe Tarifat për Shërbime të tjera do të faturohen dhe do të jenë të pagueshme në monedhën e Vendit të nisjes, përveçse kur ne përcaktojmë një monedhë tjetër gjatë pagesës ose përpara pagesës (p.sh. për shkak të moskëmbyeshmërisë së monedhës së Vendit të nisjes) ose ju zgjidhni të paguani në një monedhë tjetër.
- 5.6.2. Tarifa e fluturimit dhe Tarifat e pagueshme në një monedhë të caktuar në Uebsajtin tonë janë të vlefshme vetëm nëse ajo monedhë është monedha e Vendit të nisjes siç përcaktohet nga Ne në momentin që kryeni Rezervimin tuaj.
- 5.6.3. Ju mund të zgjidhni të paguani në një monedhë të ndryshme kur bëni Rezervimin tuaj dhe Tarifa totale e fluturimit do të konvertohet nga Ne me shumën përkatëse në monedhën e ndryshme të zgjedhur që do t'ju shfaqet gjatë Rezervimit.

5.7. Pagesa

- 5.7.1. Nëse nuk ju themi ndryshe, Rezervuesi duhet të paguajë Tarifën totale të fluturimit të plotë në momentin e kryerjes së Rezervimit tuaj. Ne duhet të marrim Tarifën totale të fluturimit në monedhën e treguar nga Ne, brenda afatit kohor të dhënë, përndryshe Rezervimi juaj do të jetë i pavlefshëm dhe do të anulohet nga Ne.
- 5.7.2. Në disa raste, për shembull kur shkaktohen taksa dhe tarifa ndërmjet lëshimit të Itinerarit (d.m.th. pas konfirmimit të Rezervimit tuaj) dhe udhëtimit tuaj, juve do t'ju kërkohet të paguani taksat dhe tarifat veçmas sipas kërkesës. Ju do të njoftoheni për një kërkesë të tillë gjatë rezervimit. Disa aeroporte mund të kërkojnë pagesën e tarifave të aeroportit, në aeroport.
- 5.7.3. Ju jeni përgjegjës për pagesën e Tarifës totale të fluturimit edhe nëse ajo ose ndonjë pjesë e saj është paguar fillimisht për Ju nga një palë e tretë.
- 5.7.4. Kur rezervoni nëpërmjet Uebsajtit ose Aplikacionit, Rezervuesi duhet të kryejë pagesën brenda periudhës kohore të treguar. Kur rezervoni përmes Call Center-it tonë, duhet ta kryeni pagesën nëpërmjet sistemit të përgjigjes zanore interaktive në përputhje me PCI.

- 5.7.5. Mënyrat e pagesës mund të ndryshojnë siç specifikohet në Uebsajt ose Aplikacion (dhe mund të përfshijnë kupona dhuratë të Wizz Air ose kredite WIZZ siç përcaktohet aty).
- 5.7.6. Transferta bankare disponohet për pagesën e Tarifës totale të fluturimit për Rezervimet që nisen nga vende të caktuara. Për detaje, shikoni Uebsajtin tonë. Ju jeni përgjegjës për çdo tarifë ose kosto në lidhje me pagesën e Rezervimit tuaj nëpërmjet transfertës bankare.
- 5.7.7. Nëse e konsiderojmë pagesën tuaj si një rrezik të lartë mashtrimi, ne do t'ju kontaktojmë drejtpërdrejt përmes numrave të telefonit të dhënë në Rezervimin tuaj, për të verifikuar detajet e Rezervimit dhe pagesës. Nëse nuk jemi në gjendje të kontaktojmë me ju, ose nuk mund të verifikojmë pagesën ose të dhënat e Rezervimit, ne rezervojmë të drejtën të anulojmë Rezervimin tuaj dhe t'ju rimbursojmë Tarifën totale të fluturimit. Pavarësisht nga çdo gjë që përmban kjo klauzolë, ne nuk marrim asnjë përgjegjësi për monitorimin ose verifikimin e pagesave tuaja për mashtrim të mundshëm dhe çdo veprim i tillë i ndërmarrë nga ne është sipas gjykimit tonë të pavarur.
- 5.7.8. NËSE PAGUANI ME KARTË KREDITI OSE DEBITI, SHUMA E TARIFUAR NË KARTËN TUAJ TË MUND TË NDRYSHOJË NGA ÇMIMI PËRFUNDIMTAR NË KONFIRMIMIN E REZERVIMIT TONË SI REZULTAT I DIFERENCAVE TË KONVERTIMIT VALUTOR NË SISTEMIN NDËRKOMBËTAR TË PËRPUNIMIT PËR PAGESAT ME KARTA. Ne nuk jemi përgjegjës për këto diferenca.
- 5.7.9. Ne do të kthejmë çdo pagesë të paidentifikuar te llogaria fillestare e pagesës. Çdo kosto që shoqërohet me një transfertë të tillë bankare do të mbartet prej jush.
- 5.7.10. Ne do të lëshojmë një faturë për Tarifën totale të fluturimit, ekskluzivisht me mjete elektronike. Fatura do të dërgohet vetëm në emailin që ju keni dhënë kur bëni Rezervimin tuaj. Ju mund të kërkonti një kopje të printuar të faturës përmes Call Center-it tonë, për një tarifë shtesë. Ju mund të kërkonti edhe një faturë të modifikuar që përmban hollësi të ndryshme të faturimit, përveç atyre që jepen pas rezervimit, për të cilat mund të kërkohet një tarifë.
- 5.7.11. Kur paguani me transfertë bankare, përveçse nëse specifikohet ndryshe nga Ne, Ju jeni të kufizuar në dy Rezervime në të njëjtën kohë për një llogari Wizz.
- 5.7.12. Nëse nuk merrni një konfirmim Rezervimi nga ne në adresën e emailit të dhënë në llogarinë tuaj të Wizz Air brenda 5 ditëve nga rezervimi, duhet të kontaktoni Call Center-in për të verifikuar vlefshmërinë e Rezervimit tuaj.

5.8. Rimbursimet

- 5.8.1. Tarifat dhe tarifat tona janë të pakthyeshme, kështu që nëse anuloni, humbisni ose nuk merrni fluturimin tuaj, nuk do të merrni rimbursim, përveçse nëse përcaktohet ndryshe në këto Kushte.
- 5.8.2. Nëse një anëtar i afërt i familjes (nëna, babai, gjyshi, fëmija, nipi, motra, vëllai, gruaja, bashkëshorti/bashkëshortja, partneri/partnerja ligjor/e) vdes brenda një muaji përpara kohës së planifikuar të nisjes së një fluturimi në Rezervimin tuaj, ju mund të kërkontë një rimbursim të barabartë me tarifën që keni paguar për fluturimet që nuk keni marrë si rezultat i asaj vdekjeje, plus çdo taksë, tarifë dhe pagesë përkatëse që keni paguar. Ju duhet ta bëni kërkesën tuaj brenda një muaji pas vdekjes dhe të jepni një kopje të certifikatës së vdekjes.
- 5.8.3. Nëse dikush në rezervimin tuaj në grup sëmuret rëndë dhe nuk është në gjendje të udhëtojë, ose nëse vdes përpara udhëtimit tuaj, Ne do t'ju rimbursojmë shumën totale për të gjithë ata që udhëtojnë në Rezervimin tuaj. Ju duhet të jepni prova të përshtatshme të sëmundjes së rëndë ose vdekjes përpara datës që do të udhëtonit.
- 5.8.4. Në rast se ne anulojmë fluturimin tuaj, ose ndryshojmë itinerarin ose oraret e planifikuara të fluturimit të përfshira në Itinerarin tuaj në përputhje me Paragrafin 6.3, ju mund ta anuloni Kontratën dhe keni të drejtë për një rimbursim të Tarifës totale të fluturimit.

6. Kryerja e ndryshimeve në Rezervimin tuaj

6.1. Orari

- 6.1.1. ORARI I NISJES DHE I MBËRRITJES I SHFAQUR NË ORARIN TONË DHE DIKU TJETËR NUK GARANTOHEN DHE ATO NUK PËRBËJNË PJESË TË KONTRATËS SUAJ TË TRANSPORTIT ME NE. SUBJEKT I KËTIJ PARAGRAFI, NE RUAJMË TË DREJTËN E NDRYSHIMEVE TË TYRE.
- 6.1.2. Ne nuk jemi përgjegjës për gabimet ose fshirjet në oraret ose informacione të tjera të lëshuara nga palët e treta në lidhje me datat ose oraret ose funksionimin e çdo fluturimi.

6.2. Fluturimet nga pika në pikë

- 6.2.1. Wizz Air është një kompani operatore e transportit nga pika në pikë dhe ne nuk operojmë fluturime tranzit ose “bileta tranziti” për fluturimet tona ose fluturimet e operatorëve të tjerë në lidhje me fluturimet tona të planifikuara komerciale.
- 6.2.2. Nëse keni rezervuar një fluturim përpara me Ne ose një kompani tjetër operatore fluturimi, kjo përfaqëson një kontratë të veçantë transporti. Ne nuk garantojmë ose pranojmë përgjegjësi për transportin e humbur në një fluturim të mëpasshëm. Aty ku zgjidhni të rezervoni një fluturim të tillë vijues, ju jeni përgjegjës për t’u siguruar që të jeni në përputhje me të gjitha kërkesat për check-in, bagazhet dhe dokumentet e udhëtimit për atë fluturim.
- 6.2.3. Ne kërkojmë që ju të keni të drejtën për të hyrë në vendin e mbërritjes së fluturimit tuaj. Ne nuk marrim parasysh asnjë fluturim vijues që mund të keni, (edhe nëse ka një itinerar transferimi në aeroport në atë aeroport mbërritjeje). Ne rezervojmë të drejtën të refuzojmë t’ju transportojmë juve dhe/ose Bagazhin tuaj nëse nuk paraqisni Dokumentet e nevojshme të Udhëtimit.

6.3. Ndryshimi i Kontratës së transportit nga Wizz Air

- 6.3.1. Neve mund të na nevojitet të ndryshojmë orarin e programuar të fluturimit, datën ose itinerarin (duke përfshirë Vendin e nisjes ose Vendin e destinacionit) pas lëshimit të Itinerarit tuaj. Ne do t’ju kontaktojmë për t’ju njoftuar për këtë ndryshim përmes emailit, Aplikacionit ose me telefon, në adresën e emailit ose në numrin e telefonit të dhënë në momentin e Rezervimit tuaj. Në rastin e ndryshimit të orarit, datës ose të itinerarit të fluturimit, nëse i pranoni ndryshimet në çdo formë, Kontrata e transportit mes jush dhe nesh do të konsiderohet e ndryshuar përkatësisht.
- 6.3.2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Konventë ose nga Rregullorja 261, ose çdo rregullore e zbatueshme që mund të zbatohet herë pas here, nëse pasi kryeni Rezervimin, por përpara orarit të programuar të nisjes së fluturimit tuaj, ne anulojmë fluturimin ose ndryshojmë orarin e programuar të nisjes dhe (i) ndryshimi dhe/ose fluturimi i ri i ofruar është i papranueshëm për ju, dhe (ii) ne nuk jemi në gjendje t’ju rezervojmë në një fluturim alternativ që është i pranueshëm për ju, atëherë pasi të kontaktoni Call Center-in tonë, ju mund të zgjidhni një prej opsioneve të mëposhtme:
- 6.3.2.1. Ne ju ri-reservojmë në një fluturim tjetër të operuar nga ne në të njëjtin itinerar ose, nëse është e nevojshme, në një itinerar të krahasueshëm, brenda 14 ditëve

para ose 30 ditëve pas datës së programuar të nisjes së fluturimit të vonuar/anuluar, sipas disponueshmërisë së ndenjësve; ose

- 6.3.2.2. Ju mund ta anuloni Rezervimin tuaj dhe të kërkontë rimbursim në kredite në "llogarinë tuaj të klientit" për fluturimin e anuluar dhe për segmentin e kthimit, nëse vlen për rastin; ose
- 6.3.2.3. Ju mund ta anuloni Rezervimin tuaj dhe të kërkontë rimbursim të tarifës totale të fluturimit të paguar për fluturimin e anuluar dhe, nëse vlen për rastin, për segmentin e kthimit.
- 6.3.2.4. Nëse pas zgjedhjes së një opsioni nga 6.3.2.1 – 6.3.2.3, Ju dëshironi të ndryshoni zgjedhjen Tuaj më vonë, mund ta bëni këtë sipas rregullave të përgjithshme në këto Kushte, dhe duke paguar tarifën përkatëse.
- 6.3.2.5. Vini re se në lidhje me Shërbimet Shtesë dhe Shërbimet e tjera, në rast anulimi, do të zbatohet politika e anulimit dhe e rimbursimit të ofruesit palë e tretë, aty ku aplikohet.

6.4. Ndryshimi i Kontratës së transportit nga ju

- 6.4.1. Ju mund ta anuloni Rezervimin tuaj deri në katërbëdhjetë ditë përpara kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj. Ju do të keni të drejtën e një rimbursimi të Tarifës totale të fluturimit pas zbritjes së Tarifës së anulimit.
- 6.4.2. Nëse e anuloni Rezervimin tuaj brenda katërbëdhjetë ditëve përpara kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj, juve do t'ju rimburohet shuma e Tarifës totale të fluturimit pas zbritjes së Tarifës për Shërbimet e tjera dhe Tarifës për ruajtjen e ndenjës.
- 6.4.3. Ju mund ta ndryshoni fluturimin tuaj në një fluturim tjetër të disponueshëm të Wizz Air nëse paguani Tarifën e Shërbimit përkatës plus diferencën e tarifës, nëse ka, për fluturimin tuaj të ri. Kjo llogaritet kur bëni ndryshimin. Nëse tarifa e re është më e ulët se tarifa origjinale, ne nuk do t'ju kthejmë diferencën. Për më shumë informacion, vizitoni Uebsajtin.

7. Udhëtimi me të Mitur

- 7.1. Ne nuk transportojmë Foshnja që janë më pak se 14 ditëshe në datën e fluturimit.

- 7.2. Ne transportojmë vetëm të Mitur nën moshën 14 vjeç nëse ata udhëtojnë me një të Rritur Shoqërues, i cili duhet të jetë në të njëjtin Rezervim me të Miturin.
- 7.3. Tarifat e tarifuara për transportin e Foshnjave disponohen në Uebsajt ose nga Call Center-i ynë.
- 7.4. Në çdo Rezervim, duhet të ketë të paktën një të Rritur Shoqërues për çdo 10 Fëmijë që përfshihen në Rezervim.
- 7.5. Në disa vende ligji i zbatueshëm në lidhje me udhëtimin e të Miturve mund të jetë më i rreptë se më lart, në këtë rast zbatohen ato rregullore. Është përgjegjësia juaj të pajtoheni me ligjin përkatës në fuqi.
- 7.6. Kërkesat për dokumente për të Miturit mund të ndryshojnë nga vendi në vend. Në përputhje me Paragrafin 11.2 (Dokumentet e Udhëtimit dhe Kërkesat e tjera) më poshtë, është përgjegjësia juaj të siguroheni që të gjithë Pasagjerët në Rezervim kanë dokumentacionin e duhur.
- 7.7. Foshnjat nuk kanë nevojë për një ndenjësë të veçantë dhe mund të ulen në prehrin e një të Rrituri Shoqërues. Fëmijët nuk mund të ulen në prehrin e një të Rrituri Shoqërues dhe duhet të kenë një ndenjësë të veçantë.
- 7.8. Nëse Rezervimi juaj është për udhëtim vajtje–ardhje, dhe Foshnja mbush dy vjeç përpara datës së segmentit të kthimit, duhet të kryhet një Rezervim i veçantë për udhëtimin e kthimit, sepse Fëmija nuk do të konsiderohet më Foshnjë.
- 7.9. Për arsye sigurie dhe funksionale, disa ndenjësë nuk janë të disponueshme për t'u blerë për një të Mitur. Mund të rezervohet vetëm një Foshnjë për çdo rresht për t'u ulur në prehrin e një të Rrituri Shoqërues. Për arsye sigurie, në bordin e të njëjtit avion mund të transportohet një maksimum prej 15 Foshnjash.
- 7.10. Ju nuk mund të jeni një i Rritur Shoqërues për më shumë se një Foshnjë dhe vetëm një Foshnjë mund të ulet në prehrin tuaj.
- 7.11. Nëse po udhëtoni me një të Mitur, duhet të merrni përgjegjësinë e plotë për të gjatë gjithë udhëtimit tuaj. Ju duhet të siguroheni që ata të jenë ulur në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt në bord. Ju nuk mund t'i kërkonte një pasagjeri që nuk është në Rezervimin tuaj të pranojë përgjegjësinë për një të Mitur në çdo kohë gjatë imbarkimit, transportit ajror ose zbarkimit.

8. Asistenca speciale

8.1. Kërkesat e Rezervimit për Asistencë speciale

- 8.1.1. Nëse keni nevojë për ndihmë të veçantë (duke përfshirë, por pa u kufizuar me, transportin e një qeni ndihmës të pranuar), ju duhet të na informoni paraprakisht sipas Paragrafit 4.1.7. ose 4.3.2 të këtyre Kushteve.
- 8.1.2. Pavarësisht çdo të drejte që ju jepet sipas Rregullores së KE-së 1107/2006 në lidhje me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe personave me lëvizshmëri të kufizuar kur udhëtojnë me avion, nëse keni një paaftësi ose gjendje mjekësore që mund të ndikojë në sigurinë tuaj dhe sigurinë e fluturimit, ne mund t'ju kërkojmë të merrni disa masa të përshtatshme, duke përfshirë kërkesën për të pasur një shoqërues për t'ju shoqëruar në fluturimin tuaj.
- 8.1.3. Përveçse nëse parashikohet ndryshe nga ligji në fuqi, shoqëruesi duhet të jetë mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe duhet të jetë i aftë fizikisht t'ju ndihmojë në rast të një situatë emergjente.
- 8.1.4. Ne do të ofrojmë asistencë të veçantë në përputhje me Rregulloren e KE-së 1107/2006.

8.2. Kushtet shëndetësore

- 8.2.1. NËSE NUK JEMI NË GJENDJE TË VERIFIKOJMË GJENDJEN TUAJ SHËNDETËSORE, NËSE KENI NDONJË SËMUNDJE TË RËNDË OSE NGJITËSE, OSE NDONJË PROBLEM TJETËR SHËNDETËSOR QË KËRKON KUJDES MJEKËSOR, ËSHTË PËRGJEGJËSIA JUAJ TË MERRNI KËSHILLËN E DUHUR MJEKËSORE NËSE JENI NË GJENDJE FIZIKE TË PËRSHTATSHME PËR TË UDHËTUAR NË MËNYRË TË SIGURT ME AVION. NË PËRPUTHJE ME DISPOZITAT E KËTYRE KUSHTEVE, NE NUK DO TË JEMI PËRGJEGJËS PËR ASNJË AKSIDENT, PËRKEQËSIM TË GJENDJES SHËNDETËSORE (DUKE PËRFSHIRË SËMURJEN OSE LËNDIMIN) QË PËSONI OSE PËR VDEKJEN TUAJ GJATË UDHËTIMIT ME AVION QË NDODHIN PËR SHKAK SE JU NUK KËRKONI OSE NUK NDIQNI KËSHILLËN E DUHUR MJEKËSORE.
- 8.2.2. Ne rezervojmë të drejtën të kërkojmë një formular të plotësuar “Fit-to-Fly” që konfirmon gjendjen fizike të përshtatshme për udhëtim me avion, që përmban miratimin e qartë mjekësor për transportin tuaj ajror, në secilin prej rasteve këtu, dhe në çdo rast ku ne kemi dyshime të bazuara nëse mund ta përfundoni fluturimin në mënyrë të sigurt, pa kërkuar asistencë të jashtëzakonshme

mjekësore gjatë fluturimit. Ne mund të kërkojmë shoqërimin nga mjekët ose infermierët e kualifikuar nëse është e nevojshme. Formulari “Fit to fly” duhet të jetë lëshuar brenda 6 ditëve nga data e fluturimit.

- 8.2.3. Nëse dështoni në plotësimin e kërkesave të përcaktuara diku këtu (përfshirë dështimin për të dhënë një formular Fit-to-Fly kur kërkohet nga ne), ose në rast se nuk jemi në gjendje të ofrojmë kushtet e përcaktuara në certifikatën tuaj mjekësore në avionin që përdorim sipas Orarit, ne do të anulojmë Rezervimin dhe transportin tuaj dhe do t’ju rimbursojmë Tarifën e fluturimit pas zbritjes së Tarifës për Shërbimet e tjera dhe Tarifës për ruajtjen e ndenjës.
- 8.2.4. Gratë shtatzëna nuk mund të udhëtojnë në fluturimet tona pas javës së 34-t të shtatzënisë. Në rast shtatzënie me disa fetuse, kufiri përkatës kohor është java e 32-të e shtatzënisë. Gratë që janë mbi javën e 28-të të shtatzënisë mund të udhëtojnë në fluturimet tona vetëm nëse na paraqesin një formular të plotësuar “Fit-to-Fly” që konfirmon përshtatshmërinë e tyre fizike për udhëtim ajror. Formulari “Fit to fly” duhet të jetë lëshuar brenda 6 ditëve nga data e fluturimit.

8.3. Transportimi i pajisjeve speciale mjekësore

- 8.3.1. Ne nuk pranojmë Pasagjerë në barela.
- 8.3.2. Koncentruerit portativë të oksigjenit (POC-të) që nuk përmbajnë gaz të ngjeshur ose oksigjen të lëngshëm mund të merren në bord, me kusht që të jepen prova rreth natyrës së pajisjes. Këto POC përfshijnë Continuous Positive Airway Pressure (CPAP) që përmban një pajisje ventilimi që fryn një fluks të butë ajri në hundë për të mbajtur rrugët e frymëmarrjes të hapura; por nuk përmban oksigjen. Këto pajisje janë të përjashtuara nga Politika jonë e Bagazheve të paregjistruara dhe mund të merren në bord si artikull shtesë. Nëse e transportoni këtë pajisje në bord, ju lutemi kontaktoni me Call Center-in tonë të paktën 48 orë përpara nisjes së programuar të fluturimit tuaj. Për më shumë informacion, vizitoni Uebfaqin tonë.
- 8.3.3. Aparatet e frymëmarrjes që përmbajnë gaz të ngjeshur ose oksigjen të lëngshëm nuk mund të merren në bord.
- 8.3.4. Ne nuk i pranojmë Pasagjerët që udhëtojnë me oksigjenin e tyre, por do t’u ofrojmë oksigjen mjekësor atyre Pasagjerëve që kanë kërkuar asistencë speciale gjatë fluturimit, sipas kufizimeve të zbatueshme.

8.3.5. Nëse keni nevojë për këtë asistencë, ju lutemi kontaktoni me Call Center-in tonë të paktën 48 orë përpara nisjes së programuar të fluturimit tuaj për të përgatitur këtë shërbim. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni Uebsajtin tonë ose kontaktoni me Call Center-in tonë.

8.4. Udhëtimi me Qen ndihmës të pranuar

8.4.1. Përveç rasteve kur ligji në fuqi parashikon ndryshe, në rastin e Asistencës Speciale ku ju duhet të udhëtoni me Qenin tuaj ndihmës të pranuar, Ju keni të drejtë të udhëtoni me Qenin tuaj ndihmës të pranuar pa tarifë shtesë, duke iu nënshtruar një kufiri prej një qeni për pasagjer për fluturim.

8.4.2. Ne nuk transportojmë qen terapie ose kafshë për mbështetje emocionale.

8.4.3. Ne kërkojmë që Ju të na informoni në përputhje me Paragrafin 4.1.7. ose 4.3.2 të këtyre Kushteve të paktën 48 orë përpara nisjes së planifikuar në mënyrë që të organizojmë udhëtimin tuaj, një njoftim i tillë duke përfshirë dhënien nga ju të dokumenteve të përmendura në Paragrafin 8.4.4 të këtyre Kushteve.

8.4.4. Një Qen ndihmës i pranuar duhet të ketë dokumentacion zyrtar që konfirmon (1) se Qeni juaj ndihmës i pranuar ka një pasaportë të përditësuar të BE-së për kafshë shtëpiake që tregon se qeni plotëson kërkesat e Rregullores së BE-së për Skemën e Udhëtimit për Kafshët shtëpiake dhe kërkesat për vaksinim dhe trajtim të vendit ku po udhëtoni; dhe (2) se është plotësisht i trajnuar për t'ju ndihmuar si Qen ndihmës i pranuar. Ne nuk jemi përgjegjës për asnjë qen guidë ose qen ndihmës që nuk ka dokumentin e duhur të nevojshëm.

8.4.5. Këto dokumente zyrtare duhet t'i mbani me vete gjatë gjithë udhëtimit tuaj.

8.4.6. Qeni juaj ndihmës i pranuar nuk lejohet të zërë asnjë ndenjësë në bordin e avionit.

8.4.7. Çdo qen ndihmës i pranuar që nuk është dokumentuar saktë, ose dokumentet nuk janë dhënë para ose gjatë udhëtimit, nuk do të lejohet të udhëtojë.

9. Ndenjëset

9.1. Ne operojmë një sistem me ndenjësë të caktuara. Kur ju kryeni checkin-in (qoftë në internet, përmes Aplikacionit për celular ose në aeroport), për ju zgjidhet një ndenjësë pa pagesë.

- 9.2. Në varësi të disponueshmërisë, mund të zgjidhni një ndenjësë specifike duke paguar tarifën përkatëse:
- 9.2.1. në kohën kur jeni duke bërë një Rezervim; ose
 - 9.2.2. nëse e keni përfunduar Rezervimin tuaj, qoftë nëpërmjet Uebsajtit ose Aplikacionit; ose
 - 9.2.3. në aeroport deri në 3 orë përpara kohës së programuar të nisjes.
- 9.3. Ju lutemi vini re se pas checkin-it, vetëm mund të ndryshoni vendin e zgjedhur paraprakisht në ndenjësë të caktuara që ndodhen në radhët e para ose në radhët e daljes që ndodhen mbi krahë.
- 9.4. Për qëllim të këtyre Kushteve të përgjithshme të transportit tarifa e pagueshme për përzgjedhjen e ndenjësës konsiderohet si Tarifë për Shërbime të tjera.
- 9.5. Pas imbarkimit në avion, juve mund t'ju kërkohet që për arsye operacionale ose sigurie të ndryshoni ndenjësën e caktuar. Në këtë rast, ju lutemi ndiqni udhëzimet e ekuipazhit të kabinës në lidhje me këtë. Nëse na nevojitet të ndryshojmë përzgjedhjen e ndenjësës së blerë prej jush, juve do t'ju caktohet rimbursimi i tarifës që keni paguar për ndenjësën e përzgjedhur.
- 9.6. Nëse gjatë rezervimit tregoni se keni aftësi të kufizuara në lëvizje, ju mund të zgjidhni checkin-in në internet, por nuk mund ta printoni Kartën e imbarkimit. Nëse keni zgjedhur checkin-in në internet, kontaktoni me Call Center-in tonë për caktimin e ndenjësës duke telefonuar numrin lokal të telefonit të dedikuar për kërkesat për asistencë speciale ose duke dërguar kërkesën tuaj në adresën e emailit të dedikuar për kërkesat për asistencë speciale (për numrat e telefonit dhe adresën e dedikuar të emailit, vizitoni Uebsajtin tonë). Pas këtij caktimi ndenjësëje, ju mund të printoni Kartën tuaj të imbarkimit. Nëse keni zgjedhur checkin-in në internet dhe e keni kryer checkin-in, por nuk kontaktoni me Call Center-in tonë që t'ju caktojë ndenjësën, ju duhet të paraqiteni në sportelin e checkin-it në aeroport ku do t'ju caktohet një ndenjësë, dhe Karta juaj e imbarkimit do t'ju printohet falas.
- 9.7. Për arsye sigurie, disa ndenjësë nuk janë të përshtatshme për të gjithë Pasagjerët. Ato që ndodhen në radhën e përparme të avionit, në daljet mbi krahë dhe në radhën e fundit.

9.8. Nëse dëshironi të bëni ndonjë ndryshim në Rezervimin tuaj ose të anuloni Rezervimin tuaj, tarifatat e paguara nga Ju për ndenjëset e caktuara nuk do të rimbursohen.

9.9. Në rast se:

9.9.1. Në ndryshojmë itinerarin ose oraret/datat e planifikuara të fluturimit të përfshira në Itinerarin tuaj ose

9.9.2. Fluturimi juaj anulohet nga Wizz Air ose vonohet për më shumë se 5 orë dhe ju keni blerë një ndenjëse në lidhje me Rezervimin, dhe për shkak të kësaj ngjarjeje ju zgjidhni:

9.9.2.1. anulimin e rezervimit tuaj, tarifa që keni paguar për ndenjësen e përzgjedhur do t'ju rimbursohet.

9.9.2.2. ndryshimin e itinerarit të fluturimit tuaj, ne do ta kalojmë ndenjësen e përzgjedhur në fluturimin e rezervuar sërish ose do t'ju caktojmë një ndenjëse tjetër ose do t'ju rimbursojmë shumën që keni paguar për ndenjësen e zgjedhur me kërkesën tuaj të paraqitur në Call Center-in tonë.

Në rast se ju caktohet një ndenjëse tjetër, do t'ju vihet në dispozicion vlera e plotë e tarifës që keni paguar për ndenjësen e përzgjedhur për përzgjedhjen dhe blerjen e një ndenjëseje në fluturimin e ri-rezervuar në vend të asaj që ju është caktuar paraprakisht në fluturimin me itinerar të ndryshuar.

10. Checkin-i

10.1. Nëse nuk keni një Itinerar kur kryeni checkin-in, duhet të jepni një kod Rezervimi. Do t'ju kërkohet të paraqitni Dokument (Dokumente) të vlefshme udhëtimi në momentin e checkin-it.

10.2. Checkin-i në aeroport është subjekt i një tarife, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në Uebsajt.

11. Në aeroport

11.1. Mbërritja në aeroport

- 11.1.1. Ju duhet të mbërrini në aeroport mjaftueshëm përpara kohës së nisjes së planifikuar të fluturimit për të kryer me kohë lënien e bagazheve (nëse keni Bagazhe të regjistruara), të kryeni të gjitha formalitetet qeveritare dhe procedurat e sigurisë dhe të paraqiteni në portë jo më vonë se 30 minuta para kohës së planifikuar të fluturimit. Procedurat dhe oraret mund të ndryshojnë në aeroporte të ndryshme dhe për fluturime të veçanta. Është përgjegjësia juaj të siguroheni që të respektoni këto formalitete, afate dhe procedura. Afati i Checkin-it mund të gjendet në Uebsajtin tonë dhe duke kontaktuar Call Center-in tonë. Koha e mbylljes së portës shfaqet në Kartën tuaj të imbarkimit dhe në Uebsajtin tonë.
- 11.1.2. Ju do të duhet të paraqisni kartën tuaj të imbarkimit dhe të gjitha Dokumentet e kërkuara të Udhëtimit. Ju lutemi shikoni Paragrafin 11.2 (Dokumentet e Udhëtimit dhe Kërkesat e Tjera). Ju duhet t'i përmbaheni çdo kontrolli ose procedure të kontrollit të sigurisë që kërkohet nga zyrtarët e qeverisë ose të aeroportit ose nga Ne. Kjo përfshin të gjithë informacionin që na kërkohet të prodhojmë për të përmbushur kërkesat e Informacionit të Avancuar të Pasagjerit.

11.2. Dokumentet e Udhëtimit dhe Kërkesa të tjera

- 11.2.1. Ne kërkojmë që të gjithë Pasagjerët të paraqesin një Dokument Udhëtimi të vlefshëm fotografik në momentin e lënies së bagazhit dhe/ose në portën e imbarkimit për të gjitha fluturimet.
- 11.2.2. Dokumenti i udhëtimit që përdorni për kontrollin kufitar dhe imbarkimin duhet të jetë i njëjti që përdoret për checkin-in.
- 11.2.3. Kërkesat për Dokument udhëtimi ndryshojnë sipas itinerarit, kombësisë dhe statusit tuaj. Zbatohen periudhat e vlefshmërisë së dokumentit, të cilat mund të jenë më të gjata se qëndrimi juaj i synuar. Kërkesat mund të ndryshojnë gjithashtu për Fëmijët dhe ata që udhëtojnë me ta. Ju lutemi vini re se ne nuk mund të japim këshilla për rrethanat tuaja specifike dhe është përgjegjësia vetëm e juaja të njiheni dhe të siguroheni që Dokumentet tuaja të Udhëtimit të plotësojnë kërkesat e vendeve të udhëtimit tuaj.

- 11.2.4. Jeni vetëm ju përgjegjës për kontrollimin dhe respektimin e të gjitha Ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave për dokumente (duke përfshirë vizat ose lejet e hyrjes dhe daljes, dokumentet shëndetësore, mjekësore dhe të tjera) të çdo vendi ku, nga ose përmes të cilit po fluturoni. Ju jeni gjithashtu përgjegjës për të kontrolluar këshillat e qeverisë për udhëtimet jashtë vendit, të cilat mund të ndikojnë në udhëtimin tuaj. Përpara udhëtimit, ju duhet të paraqisni të gjitha Dokumentet e udhëtimit dhe të gjitha dokumentet e tjera të daljes, hyrjes, shëndetit dhe dokumentet e tjera të kërkuara nga ligji, rregulloret, urdhrat, kërkesat ose kërkesa të tjera të vendeve në fjalë, dhe të na lejoni të marrim dhe ruajmë kopjet e tyre. Ne rezervojmë të drejtën të refuzojmë transportin nëse nuk i keni përmbushur këto kërkesa ose nëse Dokumentet tuaja të udhëtimit nuk duken të rregullta.
- 11.2.5. Nëse ju kërkohet të keni një vizë të vlefshme për të hyrë në vend, ju duhet të keni një vizë përpara Afatit të checkin-it. Nëse nuk e respektoni këtë kërkesë, ne nuk do të jemi përgjegjës për dëme ose kosto si rezultat i kësaj.
- 11.2.6. Ne nuk do të jemi përgjegjës ndaj jush në lidhje me marrjen dhe mbajtjen e dokumenteve të nevojshme të udhëtimit (ose dështimin tuaj për ta bërë këtë) ose dështimin tuaj për të përmbushur Ligjet e zbatueshme, kërkesat ose këto Kushte. Paraqitja nga ana juaj e Informacionit tuaj të Avancuar të Pasagjerit nuk do të thotë që Ju pranoheni ose kualifikoheni për të hyrë në ndonjë shtet apo territor. Ne rezervojmë të drejtën t'i refuzojmë transportin çdo Pasagjeri që në mënyrë të arsyeshme besojmë se nuk i është përmbajtur, ose dokumentet e të cilit ne në mënyrë të arsyeshme besojmë se nuk përputhen me këto kërkesa, ose dokumentet e udhëtimit të të cilit ne besojmë se janë të rreme, ose kur jemi udhëzuar nga autoritetet qeveritare që të veprojmë kështu.
- 11.2.7. Nëse ne detyrohemi të paguajmë ndonjë gjobë, penalitet ose nëse na shkaktohet ndonjë shpenzim për shkak të mospajtimit tuaj me rregullat e përmendura në Paragrafin 11, ju duhet të na i rimbursoni këto kosto pas kërkesës sonë. Ju gjithashtu do t'i mbuloni kostot e transportit nga shteti që nuk lejon hyrjen. Ne nuk do t'jua rimbursojmë pjesën e tarifës që lidhet me transportin drejt shtetit që nuk ju lejon hyrjen.

11.3. Zhdoganimi dhe kontrolli i sigurisë

- 11.3.1. Ju duhet të kryeni të gjitha formalitetet e emigracionit ose formalitetet e tjera të sigurisë dhe zhdoganimet e kërkuara për fluturimin tuaj. Nëse nuk i respektoni këto kërkesa, ne do të refuzojmë transportimin tuaj, do të anulojmë Rezervimin

dhe, me kërkesën tuaj ndaj nesh, do t'ju rimbursojmë Tarifën totale të fluturimit pas zbritjes së shumave të Tarifave për Shërbime të tjera dhe Tarifës për ruajtjen e ndenjës.

- 11.3.2. Ju duhet t'u nënshtroheni kontrolleve të sigurisë që kryhen nga autoritetet shtetërore dhe aeroportuale të Vendeve të prekura nga Transporti, nga operatori i aeroportit dhe nga Ne.
- 11.3.3. Nëse e kërkon Ligji i zbatueshëm, ju duhet të jeni i pranishëm gjatë inspektimit të Bagazheve tuaja që kryhet nga autoritetet doganore ose zyrtarët e tjerë të autoriteteve. Ne nuk do të jemi përgjegjës ndaj jush për asnjë humbje ose dëmtim të pësuar nga ju (përfshirë bagazhin tuaj) gjatë një kontrolli të tillë ose nga dështimi juaj për të përmbushur këtë kërkesë.
- 11.3.4. Deri në masën e lejuar nga ligji, ne refuzojmë çdo përgjegjësi për dëmet që lindin nga inspektimet e përcaktuara në Nenin 10 të këtij dokumenti dhe/ose refuzimi juaj për t'iu nënshtrohet vetë ose Bagazhet tuaja këtyre inspektimeve.

11.4. Imbarkimi

- 11.4.1. Nëse keni të drejtën për imbarkim prioritar për fluturimin tuaj, ju mund të bashkoheni me radhën prioritare në momentin e lënies së bagazhit dhe për të hipur në avion. Nëse keni të drejtë për imbarkim prioritar, kjo do të deklarohet në Kartën tuaj të imbarkimit.
- 11.4.2. Ju duhet të siguroheni që të jeni në portën e imbarkimit kur të fillojë imbarkimi për të përdorur imbarkimin prioritar. Ne nuk garantojmë që imbarkimi prioritar do t'ju mundësojë gjithmonë të hipni me përparësi pasi proceset e imbarkimit janë gjithmonë subjekt i kërkesave operacionale.

11.5. Fluturimet e humbura

- 11.5.1. Nëse humbisni fluturimin tuaj, mund të kërkonit një transferim në fluturimin tjetër të Wizz Air në të njëjtin destinacion që është i disponueshëm duke paguar një Tarifë për humbjen e fluturimit. Për ta bërë këtë, duhet të paraqiteni vetë, me dokumente të vlefshme, te agjenti ynë i biletave në Vendin e Nisjes brenda 30 minutave pas kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj të humbur, duke u siguruar që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

11.5.2. Nëse keni bërë check-in në internet, të mos keni arritur Afatin e checkin-it me bagazhet tuaja nëse keni Bagazhe të regjistruara ose keni humbur orën e imbarkimit në portë;

OSE

11.5.3. Nëse keni zgjedhur checkin-in në aeroport, të jeni paraqitur në Vendin e nisjes por të mos keni arritur Afatin e checkin-it.

11.6. NËSE KENI ZGJEDHUR CHECKIN-IN NË AEROPORT DHE KENI KRYER CHECKIN-IN NË KOHË, POR NUK KENI ARRITUR KOHËN E IMBARKIMIT NË PORTË, ATËHERË DUHET TË BËNI NJË REZERVIM TË RI DHE NUK MUND TË RI-REZERVONI SIPAS PARAGRAFIT 11.5.1.

11.7. Nëse ju ri-rezervoni fluturimin tuaj në përputhje me Paragrafin 11.5.1 dhe zgjidhni checkin-in në aeroport për fluturimin tuaj të ri-rezervuar, Ne do të paguajmë një tarifë përpunimi të pakthyeshme përveç Tarifës për humbjen e fluturimit, e cila paguhet në kohën e ri-rezervimit.

11.8. Nëse ri-rezervoni fluturimin tuaj në përputhje me Paragrafin 11.5.1, atëherë Tarifa totale e fluturimit tuaj fillestar nuk do të rimbursohet.

12. Kodi i Sjelljes

12.1. Në përputhje me Ligjin e zbatueshëm, kapiteni është në komandë të avionit dhe çdo person në bord duhet t'i bindet komandave të tij të ligjshme. Ju duhet të respektoni udhëzimet e Ekuipazhit në çdo moment gjatë transportit.

12.2. Nëse ju silleni në bordin e avionit ose në aeroport në një mënyrë që:

12.2.1. rrezikoni avionin ose ndonjë person ose pronë në bord ose në aeroport; dhe/ose

12.2.2. pengoni Ekuipazhin ose ekuipazhin në tokë në kryerjen e detyrave të tyre; dhe/ose

12.2.3. nuk i bindeni ndonjë udhëzimi të Ekuipazhit ose ekuipazhit të tokës; dhe/ose

12.2.4. përdorni fjalë kërcënuese, abuzive ose fyese ndaj Ekuipazhit, ekuipazhit në tokë ose Pasagjerëve të tjerë ose silleni në ndonjë nga këto mënyra ndaj Ekuipazhit, ekuipazhit tokësor ose Pasagjerëve të tjerë; dhe/ose

- 12.2.5. silleni në mënyrë të çrregullt, të paparashikueshme, të pasigurt ose agresive ose në një mënyrë që një Pasagjer ose person tjetër mund ta kundërshtojë në mënyrë të arsyeshme,

Ne mund të marrim masa të tilla që i konsiderojmë të nevojshme për të parandaluar vazhdimin e një sjelljeje të tillë, duke përfshirë kufizimin ose largimin tuaj nga avioni ose aeroporti, si dhe përfundimin e vazhdimin të udhëtimit tuaj në një fluturim dhe/ose transportin në fluturimin/et e ardhshme. Ju gjithashtu mund të ndiqeni penalisht për shkelje të kryera në bordin e avionit ose në aeroport. Ju do të jeni përgjegjës ndaj nesh për të gjitha kostot ose shpenzimet që rrjedhin ose janë pasojë e sjelljes suaj të papërshtatshme në bord ose në aeroport, duke përfshirë çdo kosto që rrjedh nga një devijim ose dëmtim për shkak të sjelljes suaj. Nëse një devijim është bërë i nevojshëm nga sjellja e një Pasagjeri, zgjidhja e çështjes mund të përfshijë dorëzimin e atyre Pasagjerëve tek agjentët e sigurisë ose të organeve të zbatimit të ligjit në pikën e devijimit. Ne mund të ndërmarrim veprime të tilla siç e konsiderojmë të përshtatshme për t'i rikuperuar këto kosto nga Ju. Ne gjithashtu mund të refuzojmë të pranojmë Rezervime të ardhshme për Ju në këto rrethana derisa të paguhen kostot e papaguara dhe/ose deri në momentin kur jemi të bindur se ju nuk përbëni rrezik të mëtijshëm për Pasagjerët e tjerë ose Ekuipazhin tonë ose ekuipazhin në tokë.

- 12.3. Në përputhje me kërkesat e sigurisë së aviacionit civil, në të gjitha fluturimet tona nuk lejohet duhani. Duhanpirja e çdo lloji, duke përfshirë cigaret elektronike, është e ndaluar në bordin e avionëve tanë. Çdo përpjekje për duhanpirje mund të rezultojë në ngritjen e padive të rrepta penale kundër jush dhe ne do t'ju paditim për dëmet e shkaktuara. Gjithashtu, në këto raste ne rezervojmë të drejtën të refuzojmë transportin e mëtijshëm tuajin ose të Bagazhit tuaj dhe t'ju anulojmë Rezervimin (Rezervimet).

- 12.4. Pasagjerëve u ndalohet të konsumojnë alkool në fluturimet tona, përveç alkoolit që Pasagjeri ka blerë nga Ne në bord. Sipas gjykimit tonë, ne rezervojmë të drejtën për të shërbyer alkool në bordin e avionit tonë dhe për të refuzuar shërbimin e alkoolit cilitdo Pasagjeri në bord.

- 12.5. Për arsye sigurie, ne mund të ndalojmë përdorimin e pajisjeve elektronike, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, telefonat celularë, laptopët, regjistruarit portativë, lexuesit elektronikë dhe kompjuterët tablet, lojërat elektronike ose pajisjet transmetuese, lodrat e telekomanduara dhe radiomarrëset në bordin e avionit. Lejohet përdorimi i aparateve të dëgjimit dhe i simuluesve kardiakë,

ndërsa pajisjet e tjera portative elektronike mund të përdoren vetëm në regjimin e fluturimit.

13. Refuzimi i transportit

- 13.1. Ne mund të refuzojmë t'ju transportojmë juve dhe/ose Bagazhin tuaj, ose t'ju heqim nga një fluturim nëse tashmë jeni imbarkuar, pa asnjë përgjegjësi nga ana jonë, nëse:
 - 13.1.1. Ju ose Bagazhi juaj mund të vendosni në rrezik sigurinë e avionit ose shëndetin ose sigurinë e ndonjë personi në avion ose aeroport;
 - 13.1.2. transportimi juaj ose i bagazhit tuaj mund të ndikojë në komoditetin e ndonjë personi në avion.
 - 13.1.3. jeni nën ndikimin e alkoolit ose drogës në aeroport ose në bordin e avionit;
 - 13.1.4. keni pirë duhan ose keni tentuar të pini duhan në aeroport (përveç zonave të lejuara) ose në bordin e avionit;
 - 13.1.5. jeni, ose ka arsye të mirë për të besuar se jeni në posedim të paligjshëm të drogave;
 - 13.1.6. gjendja juaj mendore ose fizike perceptohet të jetë një rrezik për veten tuaj, avionin ose ndonjë person tjetër në ose rreth tij, ose nuk keni përmbushur kërkesat shëndetësore të qeverisë, organeve të shëndetit publik ose organeve të tjera ligjzbatuese të qeverisë, të zbatueshme për vendi ku po udhëtoni;
 - 13.1.7. keni shkaktuar dëm, keni lënduar ose keni përdorur gjuhë ose sjellje kërcënuese, fyese, të turpshme ose të pasjellshme ndaj një anëtari të stafit tonë, ekuipazhit të tokës ose ndonjë Pasagjeri;
 - 13.1.8. keni bërë një kërcënim me bombë ose kërcënim tjetër sigurie;
 - 13.1.9. Sjellja juaj ka krijuar një dyshim të arsyeshëm për një kundërvajtje ose krim ose keni kryer një vepër penale gjatë procesit të Rezervimit, procesit të checkin-it ose imbarkimit, ose në aeroport apo në bordin e avionit;
 - 13.1.10. perceptoheni si rrezik për veten ose personat e tjerë ose për pronën;

- 13.1.11. nuk i keni respektuar udhëzimet tona në lidhje me sigurinë, qoftë në bordin e avionit apo në aeroport;
- 13.1.12. keni vënë në rrezik sigurinë e avionit ose të ndonjë personi në të
- 13.1.13. keni shkelur Kodin e Sjelljes;
- 13.1.14. keni refuzuar t'i nënshtroheni një kontrolli sigurie të vetes suaj ose të Bagazhit tuaj;
- 13.1.15. keni refuzuar të kryeni formalitetet e emigracionit dhe/ose doganore;
- 13.1.16. gjendja juaj fizike, rrobat tuaja ose sjellja juaj frikësojnë, neverisin ose skandalizojnë ata që janë në bord ose po imbarkohen në mjetin e fluturimit;
- 13.1.17. keni një sëmundje ose gjendje mjekësore që kërkon një formular "Fit-to-Fly" nga mjeku juaj që konfirmon gjendjen tuaj për të fluturuar dhe ju nuk paraqisni një certifikatë të vlefshme, ose përndryshe nuk na bindni se jeni në gjendje për të fluturuar;
- 13.1.18. keni nevojë për ndihmë specifike jashtë shërbimeve që Ne ofrojmë për personat me aftësi të kufizuara (shihni Paragrafin 8 dhe faqen tonë "Asistenca speciale" për më shumë detaje);
- 13.1.19. nuk keni paraqitur Dokumentet e nevojshme të Udhëtimit;
- 13.1.20. Nëse keni refuzuar t'i jepni Dokumentet tuaja të Udhëtimit një anëtar të ekipazhit të avionit, kur ne ju kemi kërkuar ta bëni këtë
- 13.1.21. Nëse keni refuzuar të na lejoni të fotokopjojmë Dokumentet tuaja të Udhëtimit
- 13.1.22. Nëse shkatërroni Dokumentet tuaja të Udhëtimit gjatë fluturimit ose para se të imbarkoheni
- 13.1.23. Ne jemi udhëzuar ta bëjmë këtë nga autoritetet qeveritare (përfshirë në lidhje me Informacionin tuaj të avancuar të Pasagjerit);
- 13.1.24. Ju nuk paraqisni një biletë të vlefshme;
- 13.1.25. ndonjë dokumentacion i paraqitur nga Ju:

13.1.25.1. është blerë në mënyrë të paligjshme ose është blerë nga një entitet i ndryshëm nga Ne ose agjenti ynë i autorizuar;

13.1.25.2. është raportuar si i humbur ose i vjedhur;

13.1.25.3. është i falsifikuar ose subjekt i mashtrimit të pagesave; ose

13.1.25.4. është ndryshuar nga dikush tjetër përveç Nesh ose agjentit tonë të autorizuar, ose është dëmtuar;

dhe në çdo rast të tillë ne rezervojmë të drejtën për ta mbajtur një dokumentacion të tillë;

13.1.26. Personi që prezantohet në momentin e lënies së bagazhit ose te porta nuk mund të provojë se është Pasagjeri i përmendur në Rezervim;

13.1.27. Ju keni manipuluar, ose keni shkaktuar qëllimisht dëmtime në avion ose ndonjë pajisje sigurie, ose keni tentuar të hyni në çdo zonë të kontrolluar pa autorizim;

13.1.28. Ne konsiderojmë në mënyrë të arsyeshme se transporti juaj dhe/ose Bagazhi juaj mund të rrezikojnë sigurinë;

13.1.29. Ju nuk keni paguar Tarifën përkatëse të fluturimit, taksat, pagesat ose Tarifat për Shërbime shtesë dhe/ose Shërbime të tjera;

13.1.30. Ju na detyrohemi para në lidhje me një fluturim (fluturime);

13.1.31. Ju nuk keni arritur të regjistrohemi brenda Afatit përfundimtar të checkin-it;;

13.1.32. Ju nuk keni arritur në portën e imbarkimit në kohë;

13.1.33. Ju keni shkelur Kushtet e përdorimit të Uebsajtit tonë;

13.1.34. Ju jeni sjellë në një mënyrë të përmendur më lart në ose në lidhje me një fluturim të mëparshëm dhe ne besojmë se mund ta përsërisni këtë sjellje;

13.1.35. Një veprim i tillë është i nevojshëm në mënyrë që të jetë në përputhje me çdo Ligj të zbatueshëm.

14. Në bord

- 14.1. Sipas gjykimit tonë, Ne mund të ofrojmë pije, ushqime të lehta dhe artikuj pa doganë për shitje në fluturimet tona. Ne nuk mund të garantojmë një mjedis pa alergjenë në bordin e fluturimeve tona.

15. Bagazhet

15.1. Bagazhi i regjistruar

- 15.1.1. Çdo pjesë e bagazhit të regjistruar duhet të peshojë jo më shumë se 32 kilogramë. Dimensionet maksimale të një cope Bagazhi të regjistruar janë: 149 x 119 x 171 cm. Ne do të refuzojmë transportin e bagazheve të regjistruara mbi këto kufij. Ne rezervojmë të drejtën të kufizojmë numrin e artikujve të Bagazhit të regjistruar për pasagjer. Informacione të mëtejshme për çdo kufizim të tillë në fuqi do të jenë të disponueshme në Uebsajtin tonë ose nga Call Center-i ynë.
- 15.1.2. NE DO TË TARIFOJMË NJË TARIFË PËRPUNIMI PËR ÇDO COPE BAGAZHI TË REGJISTRUAR. SHUMA E KËTYRE TARIFAVE DISPONOHET NË UEBSAJTIN OSE NGA CALL CENTER-I YNË. DUKE IU NËNSHTRUAR 15.1.1, NËSE PESHA TOTALE E BAGAZHIT TUAJ TË REGJISTRUAR TEJKALON LEJIMIN PËR BAGAZH TË REGJISTRUAR QË KENI ZGJEDHUR, NE DO TË TARIFOJMË NJË TARIFË PËR BAGAZHET MBI PESHËN E LEJUAR PËR ÇDO KILOGRAM TË TEPËRT SIPAS ÇMIMIT NË FUQI NË DITËN E UDHËTIMIT. SHUMA E KËTYRE TARIFAVE DISPONOHET NË UEBSAJTIN OSE NGA CALL CENTER-I YNË. NE DO TË REFUZOJMË TRANSPORTIN E BAGAZHIT TË REGJISTRUAR NËSE NUK ËSHTË PAGUAR TARIFA E DUHUR E PËRPUNIMIT DHE/OSE E PESHËS SË TEPËRT. PËRMES KËSAJ NE PËRJASHTOJMË ÇDO PËRGJEGJËSI PËR DËME QË LINDIN NGA KY REFUZIM.
- 15.1.3. Për karrocet e fëmijëve dhe karrocet e invalidëve duhet të bëhet checkin si me çdo Bagazh tjetër dhe do të transportohen falas, nëse është duke udhëtuar edhe përdoruesi i pajisjes.
- 15.1.4. Kur e pranojmë Bagazhin tuaj për transport si Bagazh të regjistruar, ne do ta marrim në ruajtje dhe do të lëshojmë një Etiketë identifikuese Bagazhi dhe një Etiketë kërkuese Bagazhi për secilën copë Bagazhi të regjistruar. Ju duhet të mbani çdo Etiketë identifikuese të bagazhit dhe Etiketë kërkuese të bagazhit si dëshmi se e keni regjistruar atë.

- 15.1.5. Bagazhi juaj i regjistruar do të transportohet në të njëjtin avion me ju, përveç rasteve kur kjo nuk është e mundur për arsye sigurie. Në këtë rast të fundit, Bagazhi juaj i regjistruar do të transportohet në një fluturim të mëvonshëm.
- 15.1.6. NËSE BAGAZHI I REGJISTRUAR PËRMBAN NDONJË PREJ ARTIKUJVE TË MËPOSHTËM:
- 15.1.6.1. të holla, letra me vlerë;
 - 15.1.6.2. bizhuteri, metale të çmuara, gurë të çmuar dhe gjysmë të çmuar;
 - 15.1.6.3. kompjuter, kamerë, videokamerë, telefon celular dhe çdo pajisje tjetër elektronike ose teknike dhe aksesorët e tyre;
 - 15.1.6.4. dokumente zyrtare, biznesi ose private;
 - 15.1.6.5. dokumente udhëtimi ose dokumente të tjera identiteti;
 - 15.1.6.6. çelësa;
 - 15.1.6.7. lëngje;
 - 15.1.6.8. ilaçe;
 - 15.1.6.9. artikuj delikatë;
 - 15.1.6.10. vepra arti dhe artizanati;

ËSHTË PËRGJEGJËSIA JUAJ TË MERRNI PARASYSH SE ATO MUND TË MOS JANË TË PËRSHTATSHME PËR UDHËTIM AJROR DHE MUND TË JENË TË SUBJEKT I DËMTIMIT OSE TË PËRKËQËSIMIT SI REZULTAT I KUSHTEVE TË UDHËTIMIT AJROR. NE NUK DO TË JEMI PËRGJEGJËS PËR VONESËN, HUMBJEN OSE DËMTIMIN E KËTYRE ARTIKUJVE.

- 15.2. Disa aeroporte mund të kenë kufizime të mëtejshme përmes politikave. Në këto raste mbizotërojnë rregulloret e aeroportit.

15.3. Bagazhi i kabinës dhe bagazhet e paregjistruara

- 15.3.1. PASAGJERËVE U LEJOHET TË MBAJNË VETËM NJË COPË BAGAZHI KABINE. BAGAZHI I KABINËS NUK DUHET TË TEJKALOJË 40X30X20 CM, DUKE PËRJASHTUAR DOREZAT DHE RROTAT. LEJOHET NJË MAKSIMUM 5 CM SHITESË PËR RROTAT E NJË BAGAZHI KABINE. DIMENSIONET E SPECIFIKUARA NË KËTË PARAGRAFI PËRFSHIJNË XHEPAT ANËSORË TË NJË BAGAZHI KABINE.
- 15.3.2. Disa shërbime opsionale Wizz Air ju lejojnë të merrni Bagazhe ekstra në bord që nuk tejkalojnë përmasat 55x40x23 cm (duke përjashtuar dorezat dhe rrotat, por maks. 5 cm rrota të jashtme) dhe peshën 10 kg, përveç Bagazhit të kabinës.
- 15.3.3. NËSE MADHËSIA DHE/OSE PESHA E BAGAZHIT TUAJ TË PAREGJISTRUAR, I REFERUAR NË 15.3.1 OSE 15.3.2, TEJKALON KUFIZIMET E MËSIPËRME, TRANSPORTI I BAGAZHEVE TË TILLA TË PAREGJISTRUARA MBIMADHËSI/MBIPESHË I NËNSHTROHET PAGESËS SË NJË TARIFE TEJKALIMI (TARIFA PËR

MBIMADHËSI/MBIPESHË) TË PËRCAKTUAR NË UEBSAJTIN TONË. NE RUAJMË TË DREJTËN T'I TRANSPORTOJMË BAGAZHET E PAREGJISTRUARA MBIMADHËSI/MBIPESHË SI BAGAZHE TË REGJISTRUARA.

- 15.3.4. Nëse është e nevojshme për shkaqe pune dhe/ose sigurie ne ruajmë të drejtën të transportojmë çdo Bagazh të paregjistruar që respekton kufizimet e mësipërme për madhësinë dhe peshën, pa pagesë në seksionin e mallrave. Kjo dispozitë nuk zbatohet për artikujt personale sipas 15.3.5.
- 15.3.5. Përveç bagazhit të paregjistruar mund të merrni në bord pa paguar tarifë të veçantë artikujt e mëposhtëm të vegjël personalë:
- 15.3.5.1. xhakete ose batanije;
 - 15.3.5.2. telefon celular;
 - 15.3.5.3. materiale leximi për fluturimin;
 - 15.3.5.4. për fëmijët nën moshën dyvjeçare: ushqim për fluturimin;
 - 15.3.5.5. artikuj pa doganë të blerë në lounge-in e nisjes, pasi keni kaluar përmes kontrollit të sigurisë;
 - 15.3.5.6. një palë paterica për personat me aftësi të kufizuara fizike;
 - 15.3.5.7. ndenjëse makine me pamje prapa për foshnja, e pajisur me rrip ndenjëseje, nëse Foshnja udhëton në një ndenjëse të paguar veçmas në avion, dhe ndenjësja e makinës është e pajisur me një kapëse që mundëson lidhjen e saj të sigurt me rripin e ndenjësës së pasagjerit.
- 15.3.6. Disa aeroporte mund të kenë kufizime të mëtejshme përmes politikave në lidhje me bagazhet e paregjistruara dhe artikujt personalë dhe të cilat mund të jenë më kufizuese sesa më lart. Në këto raste mbizotërojnë rregulloret e aeroportit.
- 15.3.7. Në aeroporte të caktuara, tarifa përkatëse mund të paguhet vetëm duke përdorur kartë krediti ose debiti. Për listën e këtyre aeroporteve, ju duhet të konsultoheni me Uebsajtin tonë ose telefononi Call Center-in tonë. Nëse ne nuk e përditësojmë listën e aeroporteve në Uebsajtin tonë, ne nuk jemi përgjegjës për çdo dëm që lind në mënyrë direkte nga kjo siç përcaktohet në këto Kushte të përgjithshme transporti dhe në ligjet përkatëse.
- 15.3.8. Bagazhin tuaj të paregjistruar dhe artikujt e tjerë të marrë në bord duhet t'i ruani në mënyrë të tillë që korridoret e kalimit dhe daljet e emergjencës të jenë të lira, në pajtim me udhëzimet e Ekuipazhit.

15.4. Mallrat e rrezikshme

15.4.1. ARTIKUJT E MËPOSHTËM PËRJASHTOHEN NGA TRANSPORTI (KËTO NUK DUHET TË VENDOSEN ME BAGAZHIN TUAJ TË REGJISTRUAR APO TË PAREGJISTRUAR, AS T'I MERRNI ME VETE SI ARTIKUJ PERSONALË):

- 15.4.1.1. armët dhe eksplozivët duke përfshirë armët e gjuetisë ose ato të përdorura për qëllime sportive siç përcaktohet nga ligji i ndonjë prej Vendeve të prekura nga Transporti të listuara në Itinerar;
- 15.4.1.2. çdo artikull apo substancë që duket si armë apo eksploziv;
- 15.4.1.3. substancat e ndezshme (përveç: pijeve alkoolike, spërkatësve për flokët, parfumit, kolonjës);
- 15.4.1.4. materialet radioaktive;
- 15.4.1.5. gazi i kondensuar (përveç: gazit CO₂ që përdoret për lëvizjen e gjymtyrëve artificiale; kontejnerët e gazit të ndezshëm që përdoret për jelekët e shpëtimit me fryrje automatike);
- 15.4.1.6. substancat helmuese ose infektive;
- 15.4.1.7. substanca gërryese (përveç: merkurit në termometra, barometra, në baterinë e karrocave të invalidëve);
- 15.4.1.8. valixhet e sigurisë, çantat ose valixhet e biznesit me pajisje alarmi të integruara që përmbajnë bateri me litium ose materiale piroteknike;
- 15.4.1.9. artikujt dhe materialet që rrezikojnë sigurinë e avionit, ose jetën, shëndetin, integritetin trupor ose pronën e atyre që janë në bord (të tilla si ato të specifikuara në Udhëzimet Teknike të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) për Transportin e Sigurt të Mallrave të Rrezikshme përmes Ajrit dhe Rregulloret e Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA) për mallrat e rrezikshme);
- 15.4.1.10. çdo artikull ose material që është i ndaluar sipas rregullave dhe rregulloreve të Vendeve të prekura nga Transporti;
- 15.4.1.11. çdo artikull që nuk është i përshtatshëm për transport, sepse janë të rrezikshëm ose të pasigurt, ose për shkak të peshës, madhësisë, formës ose karakterit të tyre, ose për shkak se janë të brishtë ose që prishen duke pasur parasysh, ndër të tjera, llojin e avionit që përdoret. Informacioni për artikujt e papranueshëm është i disponueshëm sipas kërkesës;
- 15.4.1.12. eshtrat e trupave njerëzore;
- 15.4.1.13. kafshët e gjalla (duke përfshirë kafshët shtëpiake, insektet, zvarranikët ose çdo formë tjetër gjëje të gjallë), me përjashtim të qenve ndihmës të pranuar;
- 15.4.1.14. çdo artikull i specifikuar në “Udhëzimet teknike për transportin e sigurt të mallrave të rrezikshme me rrugë ajrore” të International Civil

Aviation Organization (ICAO) dhe “Rregulloret për mallrat e rrezikshme” të International Air Transport Association (IATA) me disa kufizime të mëtejshme. Për detaje rreth kufizimeve, ju lutemi vizitoni Uebsajtin tonë.

NËSE PËRPIQENI TË MERRNI ME VETE NDONJË PREJ KËTYRE MATERIALEVE, NE MUND TË REFUZOJMË TRANSPORTIN E BAGAZHIT TUAJ DHE/OSE TRANSPORTIN TUAJ.

Nëse, pavarësisht se është i ndaluar, nëse ndonjë artikull i përmendur në këtë nen 15.4 është përfshirë në Bagazhin tuaj, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për ndonjë vonesë, humbje ose dëmtim të artikujve të tillë.

